

Ornamentika nga kompleksi i kultit të gjarprit të shtëpisë e zbatuar në arkitekturën popullore të Kosovës

*Flamur Doli**

Përmbledhje

Në këtë studim është shtjelluar ornamentika simbolike nga kompleksi i kultit të gjarprit të shtëpisë, zbatuar në arkitekturën vernakulare (popullore) të Kosovës. Gjithsesi, ndër kultet më të veçanta dhe më të rëndësishme, nga mbijetojat e kompleksit të hyjnive mbrojtëse të shtëpisë, në kontekst të besimeve popullore të shqiptarëve, bën pjesë edhe kulti i gjarprit.

Në kontekst të lëndës së mbarështuar në këtë studim, mirëfilli është konstatuar se, ornamentet nga kulti i gjarprit, për shkak të karakterit dhe simbolikës së tyre, u aplikuan përherë në vendet apo në elementet kompozicionale më të ekspozuara të shtëpisë, meqë përdorimi i tyre kishte funksion magjik, mbrojtës dhe fatsjellës. Për më tepër, aplikimi i këtyre ornamenteve, kryesisht në formë artistike të relievit të ulët, shquhet për një strukturim kompozicional të harmonizuar organikisht me konceptin estetik formësues dhe arkitektonik të ndërtimit popullor, apo elementeve strukturale të tij.

Për të dhënë një pasqyre sa më plotë dhe prova të shumta në kontekst të aplikimit të ornamenteve nga kulti i gjarprit me interpretim gjeometrik abstrakt të simbolit të tij, apo me paraqitje artistike reale, është analizuar një numër i konsiderueshëm i objekteve të ndryshme etnografike shqiptare tek të cilat u aplikuan këto ornamente.

Në këtë studim mirëfilli provohet se, kulti i gjarprit është pjesë përbërëse e trashëgimisë komplekse etnokulturore e popullit tonë. Ky kult, në vertikalen diakronike, u zhvillua në një vijimësi të pandërprerë, në harkun kohorë, që nga ilirët deri tek shqiptarët e kohës sonë.

* Dr. Sc. Flamur Doli, Prof. Ark. Departamenti i Arkitekturës, Fakulteti i Ndërtimitarisë dhe Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës, Republika e Kosovës, flamur_doli@hotmail.com

Fjalët kyç: *kulti i gjarprit, ornamentika simbolike, hyjnia mbrojtëse e shtëpisë, besimet popullore, mitologjia ilire, paraqitja figurative realiste dhe abstrakte e gjarprit, kulti i diellit.*

Ornamentika popullore nga kompleksi i hyjnive mbrojtëse të shtëpisë

Ndër kultet më të veçanta dhe më të rëndësishme, nga mbijetojat e kompleksit të hyjnive mbrojtëse të shtëpisë, bënë pjesë edhe kulti i gjarprit. Ky kult në arealin e Ballkanit na paraqitet shumë herët, që nga periudha parahistorike e neolitikut. Mirëpo, me paraqitjen e ilirëve në këtë truall, rëndësia e këtij kulti ngrihet deri në atë masë sa që merr rol dominant në sistemin mitologjik dhe religjioz të ilirëve të jugut. Ndërkaq, gjarpri si simbol i pëlleshmërisë, i rojës së shtëpisë dhe vatrës, apo si hyjni ktonike, me shumë elemente është i lidhur me kultin e Diellit. Kulti i Diellit, tek ilirët, sikundër edhe tek popujt e tjerë, në këtë shkallë të zhvillimit, ishte themel në të gjitha manifestimet religjioze. Thuhet se ai u zhvillua më shumë në viset veriore ilire.¹ Edhe përkundrajt sfidave të mëdha gjatë historisë, ilirët e ruajtën kompaktësinë e traditave të tyre kulturore. Fryma konservative në ruajtjen e kulteve të të parëve të tyre, pastaj vetëdija dhe shpirti i pathyeshëm i ilirëve, bëri që këto besime religjioze të ruhen deri në ditët tona. Për rrjedhojë, siç do të provojmë në vijim, kulti i gjarprit edhe në besimet popullore të shqiptarëve paraqitet si i veçantë.

Ndër shqiptarët, gjarpri është i lidhur fort me shtëpinë dhe familjen. Ndaj, në rite e besime popullore shqiptare, gjarpri paraqitet si hyjni mbrojtëse e jetës, e mirëqenies dhe mbarësisë në familje.²

Ornamentet nga kulti i gjarprit, varësisht nga periudha historike, u aplikuan në teknike të ndryshme, me paraqitje artistike figurale realiste apo në stilizim abstrakt gjeometrik.

¹ Aleksandër Stipčević, *Ilirët, Historia, Jeta, Kultura, Prishtinë, 1980, f.48 dhe f. 188.*

² Mark Tirta, *Mitologjia ndër shqiptarët, Tiranë 2004, f.145.*

Paraqitja artistike figurale-realiste me tipare plastike haset që nga neoliti, siç është rasti me figurinën e gjarprit prej terakote, me tipare unike në gjithë kompleksin neolitik ballkanas-anatolik.

Kjo figurinë arkeologjike u zbulua në shtresën kompakte të argjilës së një shtëpie në vendbanimin neolitik "Tjerrtorja", në periferi të Prishtinës. Trupi i gjarprit të fragmentuar, të cilit i mungon koka, është i zbukuruar me incizim zigzag të shoqëruar nga të dyja anët me therje vertikale (fig. 3.).³ *Pa dyshim se ky gjarpër shërbente për qëllime kulti.*⁴

Më pas, me formimin e etnikumit ilir, gjarprin me paraqitje figurale realiste e hasim edhe tek byzylykët prej argjendi, të cilat u gjetën në një varrezë të çiftit princor ilir, në Banjë të Pejës, shek.VI-V p.e.s.⁵

Tiparet formësuese të këtij artefakti ilir (fig.4.), përkatësisht të byzylykut, i cili në dy skajet e tij përfundon në formë kokash gjarpri me paraqitje realiste, janë shprehje e futjes së paraqitjes figurale në artin ilir që nga faza e hershme e periudhës së hekurit. Natyrisht se, *motivi i gjarprit rrënjët e tij të thella i ka në religjionin ilir.*⁶

Kjo bëri që *kulti i gjarprit në mitologjinë ilire* të ruhet në një vijimësi të pakëputur deri në ditët tona. Prandaj, ishte e natyrshme që në vitin 2001, gjatë gërmimeve arkeologjike në një qendër ilire në Kosovë, përkatësisht në *vendbanimin ilir të Çifllakut*,⁷ shek. I-II-të i e. sonë, të zbulohet paraqitja figurale e

³ Fakti se, *figurinat prej terakote*, sipas besimeve mitologjike të asokohshme, *fshiheshin nga syri i njeriut*, na bënë të kuptojmë se, *në periudhën neolitike dhe eneolitike, sistemi i besimeve religjioze përbëhej prej disa koncepteve*, përkatësisht *formave të manifestimit të tij*. Do të thotë se, *kulti i hyjnive mbrojtëse të shtëpisë* manifestohej përmes konceptit të *objekteve të padukshme të kultit* - të fshehura nga syri i njeriut, si dhe përmes konceptit të *objekteve*, përkatësisht *ornamenteve të dukshme të kultit*, të aplikuara pikërisht në vendet më të theksuara për syrin e njeriut.

⁴ Radoslav Galović, Predionica, neolitsko naselje kod Prištine, Muzej Kosova i Metohije, Priština 1959, f. 25, Tab.6/1.

⁵ Arheološko blago Kosova i Metohije, od neolita do ranog srednjeg veka, Katalog. Priština: Muzej 1998 (Beograd), f.577.

⁶ Milutin Garašanin, Prahistorija, Beograd/Zagreb/Mostar 1982, faqe 137.

⁷ Venbanimi i Çifllakut ndodhet buzë luginës së Drinit të Bardhë, në të djathtë të rrjedhës së tij. Kufizohet në veri me fshatin Kramovik, në lindje me Gurin e Kuq, ndërkaq në perëndim me Meqen dhe Rakovinën. Në këtë qendër antike u zbuluan objekte cilësore arkitektonike të realizuara nga *mjeshtrit vendas*. Luan Përzhishta, Vendbanimi ilir i Çifllakut, Albanika - Ekskluzive, 71/2007, faqe 66.

gjarprit e skalitur në një bllok mermeri⁸ në teknikë të relievit të ulët - të dalë nga sipërfaqja e gurit.⁹

Kështu, në fig.1., jo rastësisht, është paraqitur dukja e gjarprit të vërtet, *Vipera berus*, nga familja e gjarpërinjve *Viperiadae*, nepërkave helmuese, e cila e popullon gjithë territorin paleoarktik, pra edhe pjesën dërrmuese të territorit, dikur të banuar nga ilirët, kurse sot nga shqiptarët.¹⁰

Mbështetur në vrojtimet analitike - krahasuese kuptojmë mirëfilli se *kokat e gjarprit tek byzylyku ilir* kanë një strukturë formësuese figurale e cila në gjithë tiparet e saj, deri në hollësi, i riprodhon ato të gjarprit të vërtet të zënë ngoje më sipër.¹¹

Për më tepër, kjo specie e gjarprit, nuk shërbeu si mostër për t'i riprodhuar tiparet natyrale - reale të tij, vetëm nga artisti i periudhës së hekurit, porse ai shërbeu edhe për mjeshtrin e periudhës më të lashtë - neolitike, siç është rasti me *figurinën e gjarprit prej terakote*, paraqitur në fig.3. Këtu, mjeshtri i kësaj periudhe, pjesën e sipërme, shpinën e gjarprit prej terakote, e zbukuroi me incizime zigzage të shoqëruara nga të dyja anët me therje vertikale, me radhitje të rregullt, zbukurim ky që i shëmbëllen në tërësi larave të shkruara në shpinën e gjarprit të vërtet të llojit *Vipera berus*, paraqitur në fig.1.

Po qe se e bëjmë një kërcim të madh kohor, në diakroni të ekzistencës së pandërprerë të këtij kulti të gjarprit, do të shohim se ai me paraqitje figurale realiste mbijetoi deri në ditët tona edhe në besimet popullore shqiptare. Në formë figurale realiste gjarpri u aplikua edhe në artefaktin etnografik shqiptar, paraqitur në fig.2.

Madje, ç'është me shumë rëndësi, gjarpri i paraqitur në fig.2.¹², punuar nga vajza drenicase me penj (tekstil) dhe rruaza

⁸ Po aty, ky bllok mermeri ka gjasa të jetë përdorur si bazament i një *stete*.

⁹ Po aty.

¹⁰ Opća enciklopedija, 7. Zagreb 1981, f.109.

¹¹ Po kështu, më vonë, në periudhën e Antikës, në artin ilir, në paraqitjen relievo të gjarprit në fragmentin e Ripçit, si dhe në paraqitjet e dy gjarpërinjve të tjerë në urnën e Sesteniusit (shek. I-IV i e. sonë), pa vështirësi e shquajmë nepërkën e bosnies (*vipera amodyttus*). Pasi që përmbajtja figurale, e aplikuar në këto objekte, i përket *kultit të të vdekurve*, ajo u nënshtrohet zbatimit të skemave kompozicionale të caktuara me stil të njëjtë. (Krhs. Dimitrije Sergejevski, Iz problematike ilirike umjetnosti, Godišnjak III/1, Sarajevo 1965, f.124).

¹² Marrë nga koleksioni i pasur etnografik i Nexhmi Bardhit, Zabel i Ulët, Krahina e Drenicës, viti 1998.

dyngjyrëshe, gati se në tërësi i shëmbëllen gjarprit të vërtetë paraqitur në fig.1. Edhe në këtë rast, shpina e gjarprit (fig.2.), sikundër tek gjarpri neolitik, është e dekoruar me vija zigzage, realizuar në tri radhë rruazash me ngjyra¹³. Prej sosh, dy radhët e jashtme janë punuar me rruaza ngjyrë të zezë, ndërkaq rruazat e radhës së mesme, me ngjyrë të gjelbër.

Për shkak të rëndësisë së madhe që kishte kjo *kafshë kulti në mbijetojat e besimit popullor shqiptar*, ishte traditë që vajzat para martesës ta punonin për *pajë*, dhe natën e dhëndërisë ta varnin në mure të "*çilerit*", prej nga nuk e largonin më. Kjo dukuri, si mbijetojë e besimit pagan, ndër shqiptarë u ruajt gjithandej, ngase kjo kafshë ktonike, përveç tjerash, simbolizonte edhe *pëlleshmërinë e gruas*.

Paraqitja figurale e gjarprit në funksion të rojes së shtëpisë

Po kështu, gjarprin në arkitekturën popullore shqiptare me paraqitje artistike figurale punuar në hekur dhe aplikuar në *funksion të rojës së shtëpisë*, e hasëm edhe në dyert e portës së madhe të oborrit të shtëpisë së familjes ZHERKA në Gjakovë (fig.7., fillimi i shek.XX).

Strukturën formësuese e funksionale të *rezës së hekurt*, për mbylljen e dyerve të mëdha të oborrit të kësaj shtëpie, e sajojnë dy gjarpërinj, paraqitur në formë realiste me stilizim të thjeshtësuar. Njëri syresh, siç shohim nga fig.7., është i formësuar në mbarim të pjesës plloçake të përzgatur të rezës, e cila, në teknikë të incizimit, është e zbukuruar në formë vijash zigzage në tri radhë, prej të cilave radha e mesme, nga të dyja anët, është e shoqëruar me trekëndësha në një ritëm të rregullt.

Po këtë formë strukturale të shprehjes artistike të gjarprit, simbolizuar me stilizim abstrakt gjeometrik, në formë të vijës zigzage të shoqëruar në të dyja anët me trekëndësha, e hasim edhe tek stela ilire e Sinjit (Kroaci), me emra ilirë PAIO e CUIO, shek. I i e. sonë (fig.11).

¹³ Me këtë rast, mendojmë se është e tepërt për të theksuar se artisti popullor nuk ishte në dijeni për veprën-artefaktin e artistit të neolitikut. Porse, s'do mend se të dyja këto vepra për mostër kishin gjarprin e vërtetë nga specia e njëjtë.

Në këtë stelë ilire, ornamentin e kultit të gjarprit është paraqitur në një kompozim artistik gjeometrik së bashku me ornamentin e kultit të Diellit në formë ylli-rozete gjashërrempëshe brendashkruar në rreth.

Po kështu, disa shekuj më pas, në mesjetën e hershme të periudhës arbërore (shek.VI-VIII të e. sonë), edhe në broshin e derdhur në bronz na paraqiten së bashku kultin e gjarprit dhe kultin e Diellit. Në pjesën rrethore të kësaj stolie, motivi i kultit të gjarprit është paraqitur në formë të stilizimit abstrakt gjeometrik, përkatësisht në formë të meandrit - vijës së thyer zigzage, e cila e qarkon figurën e një kafshe, në trupin e së cilës janë paraqitur pesë ornamente nga kultin e Diellit në formë të rrahëve bashkëqendrorë (fig.10.).

Bashkimi i kultit ktonik dhe kultit të Diellit

Paraqitja e këtyre dy kulteve së bashku, në formë të artit gjeometrik, ndodhi në përputhje me periudhën kur paraqitja realiste figurale e kafshës ktonike të gjarprit u alternua me paraqitjen simbolike abstrakte - gjeometrike të saj. Si dhe me kohën kur, sipas studiuesit Gj. MANO-ZISI,¹⁴ në shekujt e fundit të epokës para Krishtit, dhe në fillim të epokës sonë, tek ilirët, përveç ekzistimit të njësimin kulturor, mënyrës së jetesës, djegies në tumule apo varrimit, kemi edhe *bashkimin e kultit ktonik dhe diellor*.

Bashkimi i këtyre dy kulteve mund të shpjegohet edhe me faktin se, sipas A. STIPÇEVIQIT,¹⁵ gjarpri nuk ishte vetëm simbol ktonik, porse edhe simbol i *pëlleshmërisë bimëtore* dhe ishte i lidhur edhe me burimet e tjera të jetës siç ishte Dielli. Në Egjipt dhe në Greqi, gjarpri ndonjëherë paraqitet edhe si *personifikim i Diellit*.

Për rrjedhojë, këto dy kulte të paraqitura së bashku, qoftë në *formë të stilizimit abstrakt gjeometrik*, apo në *formë figurale - realiste*, i hasim edhe te ballina e djepit të Rrafshit të Dukagjinit (fig.9.), pastaj tek nëntrarëri dhe shtylla qendrore e ballinës së hajatit

¹⁴ Djordje Mano-Zisi, Antika, Beograd/Zagreb/Mostar 1982, f.21.

¹⁵ Aleksandër Stipçeviq, Simbolet e kultit te ilirët, Prishtinë 1983, f.60.

dhe në pjesë të tjera të hambarit në fshatin Grashticë, komuna e Prishtinës (fig.12., fillimi i gjysmës së dytë të shek. XIX¹⁶), më tej, tek harku i portës së vogël të oborrit të kullës shqiptare të SYLËREXHËVE në Vranoc të Lugut të Baranit (fig.13., fundi i shek. XIX), më pas, tek kulla e Rexhë FETAHUT në Gurakoc të Istogut (fig.16., gjysma e parë e shek.XIX), tek porta harkore e kullës në fshatin Perlat të Epërm në Mirëditë,¹⁷ tek furka e Rafshit të Dukagjinit (fig.22.), tek shtëpia e ndërtuar në mëhallën e Pulajve, fshati Vërmicë (fig.15.), tek guri mbivarror në fshatin shqiptar Vuksan Lekiq te Tuzi (gjysma e dytë e shek. XVII¹⁸), si dhe tek porta harkore në kullë të Ramadan SELIMIT në fshatin Krajk të Hasit, (fig.19.), ornamentit të kultit të Diellit në teknikë të relievit të ulët është i skalitur në gurin tjetër të harkut të kësaj porte (shek. XIX) etj.

Interpretimi abstrakt gjeometrik i simbolit të gjarprit

Veç kësaj, aplikimin e ornamentit nga kulti ktonik i gjarprit me interpretim gjeometrik abstrakt të simbolit të tij, qoftë me vetëdije apo pa vetëdije, e hasim në raste të panumërta edhe në

¹⁶ Do theksuar se në këtë hambar, të tipit megaron, janë daltuar një numër imponant prej 34 motivesh ornamentale, kryesisht prej kultit të Diellit si dhe prej kultit të gjarprit.

¹⁷ A. Baçe dhe të tjerë, Historia e Arkitekturës shqiptare, Tiranë 1980, f.580.

¹⁸ Šefik Bešlagić, Stari malisorsi nadgrobnii spomenici u Vuksan Lekiću, Buletin i Muzeut të Kosovës, nr.X, Prishtinë, 1970, f.376, fig.5. Gjatë evidentimit të përmendoreve mbivarrorë, të quajtura "steqke", në fshatin e Malësisë, Vuksan Lekiq te Tuzi, autori ka përnjohur varret e lashta të shqiptarëve malësorë të besimit katolik, me një rëndësi shumë të madhe. Këto varre ai i daton pjesërisht në shekullin e XVII, dhe kryesisht në shek. XVIII. Nga ilustrimet e dhëna në këtë studim shohim se në gurët mbivarrorë janë skalitur në teknikë të relievit të ulët dhe të lartë një mori motivesh ornamentike me një simbolikë të caktuar. Madje në disa raste, figurat e të ndjerëve, shquhen për paraqitjen artistike në formë skulpture. Veç kësaj, në këta gurë mbivarrorë janë skalitur një mori ornamentesh me një larushi kultesh si mbijetoja të besimit pagan. Këtu na paraqitet kulti i Diellit, kulti ktonik i gjarprit, dhe i kafshëve të tjera tokësore, pastaj kultet mbrojtëse të natyrës, përkatësisht hyjnitë e vegetacionit etj. Në kuadër të këtij kompleksi ornamentesh me simbolikë të caktuar, janë skalitur në reliev edhe figura të ndryshme gjeometrike, siç është trekëndëshi, pastaj ornamente formash komplekse prej më të ndryshmeve, si dhe një mori armësh të karakterit të ndryshëm, etj. S'do mend se në këtë rast kemi të bëjmë me besim apo fenomen shumë kompleks shoqëror dhe religjioz.

objektet e tjera arkitektonike popullore apo etnografike shqiptare. Do të thotë, e hasim të aplikuar edhe në tekstilet popullore shqiptare, përkatësisht tek veshjet e femrave të punuara nga endëset shtëpiake, pastaj tek veshjet e burrave, tek kaptellët e djepit, më pastaj tek arkat e nuseve, tek drugëzat e avlëmendit, tek furkat, tek koshat (koçekët), etj.

Një interpretim gjeometrik abstrakt të gjarprit, aplikuar në teknikë të incizimit në formë zigzage, e hasim edhe tek ena dy vjega prej balte e periudhës së hekurit (shek.IV-V p.e.s., fig.5.¹⁹), të gjetur në nekropolin tumular ilir në fshatin Romajë të Dukagjinit. Po këtë formë abstrakte figurale, siç shohim nga fig.6., e hasim edhe në shokën - kaptellin e djepit të punuar me rruaza me ngjyra, pastaj tek jastëku nga Dukagjini (fig.8.), përreth portës, në ballinë të hambarit në Grashticë (fig.12.), si dhe tek marama me motive të thurura, fundi i shek. XIX, Dukagjin. Nga vrojtimi i jastëkut nga Dukagjini dhe detajit të fashetës së hambarit në Grashticë, kuptojmë se, përveç përkimeve të plota ndërmjet këtyre dy paraqitjeve gjeometrike të gjarprit, edhe mbarimet e tyre shquhen me një formësim të njëjtë. Kësaj, do t'i shtonim se pikëzimin mes për mes strukturës zigzage në ornamentin e hambarit, si të tillë, e hasim edhe në gjetjet arkeologjike ilire.

Ndërkaq, shokën - kaptellin e djepit me aplikim abstrakt gjeometrik të simbolit të gjarprit në Krahinën e Drenicës e hasim në raste të panumërta. Tek endja dhe zbukurimi i tyre me rruaza, në të gjitha rastet, pashmangshëm, është aplikuar ngjyra e kaltër. Në rastin konkret, me rruaza ngjyrë të kaltër janë formuar trekëndëshat të cilët nga të dyja anët e shoqërojnë meandrin në formë zigzage. Si ngjyra e kaltër po ashtu edhe trekëndëshi janë aplikuar në funksion apotropeik.²⁰ Objekti

¹⁹ Arheološko blago Kosova i Metohije, od neolita do ranog srednjeg veka, Katalog. Priština: Muzej 1998. (Beograd), f.570.

²⁰ Këtu do përmendur edhe mbijetojën e besimit pagan më pak të përhapur të kultit të flijimit të gjarprit në funksion të mbarësisë së punëve rreth ndërtimit të shtëpisë. Ushtrimi i këtij kulti, siç mësojmë, është bërë edhe me rastin e hapjes së themeleve të kullës së familjes Bajraj, në fshatin Istog i Poshtëm me ç'rast është therur një gjarpër, gjaku i të cilit është derdhur rreth e përçark themelit, dhe së fundi i tërë trupi i tij është murosur në këndin lindor të këtij themeli. (Krhsh. Ukë Xhemaj, Etnokultura shqiptare në Podgur, Prishtinë 2003, f.259).

etnografik i kaptellit vendoset mbi rrethin e djepit. Në shumë raste, në këtë element të djepit është daltuar gjarpri në formë *artistike reale*. Në Dukagjin, gjarprin e daltuar kësisoj e hasim edhe në anën e jashtme të dërrasës anësore të djepit²¹, pastaj në kaptellin e një djepi nga një fshat afër Pejës²², si dhe në djepin nga Podguri²³, pastaj edhe në kaptellin e një djepi tjetër nga Kosova²⁴, etj.

Paraqitja e gjarprit në formë artistike reale

Paraqitjen realiste të gjarprit, siç thamë edhe më lartë, e hasim të skalitur në portën harkore të kullës së SYLËREXHËVE në Vranoc²⁵ (fig.13.), si dhe në një gurë këndor të “shpisë së gatë”, në afërsi të portës hyrëse të kësaj kulle (fig.20.), pastaj në elementin harkor të dritares së ndërtuar në nivelin e katit të dytë - në fasadën anësore të kullës së Ali GECIT, Llukë e Poshtme, Deçan fig.21.²⁶, më tej, tek porta harkore e kullës së Ramadan SELIMIT në fshatin Krajk të Hasit (fig.19.), tek porta harkore e kullës së Sadri SALIHIT në fshatin Dubovik të Dukagjinit (fig.17.), tek guri këndor i kullës së Haxhi ZEKËS në Pejë, në fasadën e kullës së Rexhë FETAHUT në Gurakoc të Istogut (fig.16.), tek guri i djathtë - vertikal i kornizës së portës harkore të kullës së Bardhosh DINËS në Dubovik, komuna e Deçanit²⁷, etj.

²¹ Shih: foto dokumentacionin e vëllimshëm të autorit.

²² Mark Krasniqi, *Gjurmë e gjurmime*, Prishtinë 1979, f.457.

²³ Ukë Xhemaj, *Etnokultura shqiptare në Podgur*, Prishtinë 2003. f.317.

²⁴ Shih foto dokumentacionin e autorit.

²⁵ Kur është fjala për kullën në Vranoc, përkatësisht për *Lugun e Baranit*, do theksuar se nga eksplorimet e bëra në terren kuptuam se arkitektura popullore shqiptare e kësaj treve shquhet me një zbukurimore simbolike shumë të pasur.

²⁶ Në elementin harkor të kësaj dritareje, në teknikë të relievit të ulët - të dalë nga sipërfaqja e gurit, janë skalitur dy gjarpërinj, me koka në pjesën e lartë, të cilat e shikojnë njëra tjetrën. Do të thotë, paraqitje artistike kompozicionale e këtyre dy gjarpërinjve, konsiston në një strukturim kompozicional, të thuash, simetrik, ndaj boshtit vertikal të dritares, përkatësisht elementit harkor të saj.

²⁷ Në këtë rast na paraqiten të skalitura, në teknikë të relievit të ulët - të dalë nga sipërfaqja e gurit, dy gjarpërinj në pozitë paralele - të pjerrët, me koka në pjesën e lartë.

Në këtë kontekst do të veçonim paraqitjen e gjarprit në formë figurale - realiste, aplikuar në teknikë të basorelievit (të dalë në formë plastike nga sipërfaqja e gurit). Ky ornament i gjarprit është aplikuar në gurin vertikal të djathtë të portës harkore të njëres kullë, ndërtuar në lagjen e HOXHAJVE në Junik²⁸.

Siç mund të vërejmë nga më sipër, për shkak të karakterit dhe simbolikës së tyre, këto ornamente gjarpërinjsh u aplikuan përherë në vendet më të ekspozuara, meqë përdorimi i tyre kishte funksion magjik, mbrojtës dhe fatsjellës. Për më tepër, edhe aplikimi i këtyre ornamenteve, kryesisht në formë artistike të relievit të ulët, shquhet për një strukturim kompozicional të harmonizuar organikisht me konceptin estetik formësues dhe arkitektonik të ndërtimit popullor, apo elementeve strukturale të tij.

Kulti i diellit dhe i gjarprit

Kështu, tek kulla e SYLËREXHËVE në Vranoc, përkatësisht në harkun e portës së vogël të dyerve të oborrit, nëpër të cilën hyjnë anëtarët e familjes dhe mysafirët, janë aplikuar gjithsej shtatë (7) motive dekorative nga *kulti i Diellit dhe i gjarprit* (fig.13.)²⁹. Ndërkaq, tek porta e madhe harkore e oborrit, në pjesën e poshtme të shtyllës së djathtë të saj, si dhe mbi pjesën e majtë të harkut, janë skalitur nga një ornament nga kulti i Diellit në formë ylli-rozete gjashtërrembëshe brendashkruar në rreth³⁰.

²⁸ Lidhur me këtë shih foto dokumentacionin e atorit, fotografuar nga Sadri Hadërgjonaj.

²⁹ Në kuadër të këtij kompleksi ornamentesh nga *kulti i gjarprit dhe i Diellit*, kemi edhe dy motive të tjera astrale të gjysmëhënës, skalitur nga të dyja anët e motivit diellor në formë spiraloide. Po kështu, edhe tek porta harkore e kullës së Ramadan Selimit në fshatin Krajk të Hasit, përveç ornamentit nga kulti i gjarprit dhe i Diellit, na paraqiten edhe *tri motive të tjera astrale të gjysmëhënës*. Po i njëjti motiv nga *kulti i hënës* së bashku me një kafshë ktonike është skalitur edhe në një gur këndor të kullës së zënë ngoje më sipër. Më tej, motivi i gjysmëhënës, së bashku me kafshën ktonike të gjarprit skalitur në formë realiste, na paraqitet edhe tek porta harkore e kullës së Sadri Salihit në fshatin Dubovik të Dukagjinit. Kuptohet qartë se paraqitja së bashku e këtyre mbeturinave besimesh në hënë, në Diellin e në elemente të tjera të natyrës, janë shprehje e karakterit kompleks të besimeve pagane që lidhet me natyrën.

³⁰ Dy ornamente të këtilla janë skalitur edhe në harkun e poshtëm të dritares së djathtë

Po kështu, në fasadën ballore (lindore) të kullës, pranë portës së zënë ngoje, përfaqësohet në gurin e mesëm të latuar të këndit të majtë të kësaj fasade, është skalitur edhe një motiv dekorues nga kulti i gjarprit. Në këtë rast, gjarpri i skalitur në këtë gurë, në teknikë të relievit të ulët – të dalë nga sipërfaqja e gurit, bishtin e ka të mbledhur në formë spirale, apo siç thuhet në popull: të mbledhur “kutullaç” (fig.18.)³¹.

Paraqitja e gjarprit në arkitekturën popullore në format e përshkruara më sipër, përkatësisht skalitja e tij në pozita karakteristike, nga e cila gjarpri “vëzhgon – kontrollon” hyrjen e çdo personi në oborr apo në shtëpi, mirëfilli simbolizon hyjninë mbrojtëse të shtëpisë dhe anëtarëve të familjes.

Sipas dëftimeve të shpeshta të Zyliha (Gunga) DOLIT, e lindur në dekadën e nëntë të shek. XIX, “bolla e shpisë”, e cila qëndronte në gurët e oborrit të madh të shtëpisë së saj, në lagjen e Çabratit të Gjakovës, i njihte dhe i mbronte të gjithë anëtarët e familjes së shtëpisë. Sipas saj, “bollën e shpisë” shpeshherë e shihnin të mbledhur kutullaç. Pra, kulti i gjarpërit, në besimet popullore shqiptare, si mbijetojë e besimeve të lashta pagane, nuk gjëlloi vetëm në fshat, porse, ai fuqishëm gjëlloi edhe në qytet.

të odës së burrave, vendosur në fasadën ballore (lindore) të kësaj kulle. Me të hyrë në oborr të kullës, deshëm apo s’deshëm, shikimi ynë fërkohet me portën harkore të hyrjes në kullë, dhe me ornamentikën e saj të pasur dhe estetike, si rrallë në ndonjë kullë tjetër. Në pjesën e poshtme të harkut të kësaj porte, në të dyja anët e saj, janë skalitur dy ornamente nga kulti i Diellit në formë ylli – rozete gjashtëmbëshe brendashkruar në rreth. Po kështu, edhe mbi pikën më të lartë të këtij harku, skalitur në një gur rrethor, është aplikuar edhe një ornament tjetër i këtij lloji, përmasash paksa më të mëdha, krahasuar me dy ornamentet e poshtme. Këto tri ornamente së bashku e sajojnë rendin prej tri ornamentesh me kontur rrethor, i cili, që në kohët ilire, e simbolizonte *treshin diellor*, përkatësisht Diellin në lindje, në zenit dhe në perëndim. Në shtyllën e majtë të kornizës së portës harkore janë të skalitura dy ornamente me karakter gjeometrik, të cilat, si të tilla, i hasim gjithandej të aplikuar në kulturën materiale të popullit shqiptar. Në mes të këtyre dy ornamenteve është skalitur një ornament tjetër rrethor, nga kulti i Diellit, përmasash më të vogla, krahasuar me ato të treshit Diellor. Më tej, në brendi të kësaj kulle, përkatësisht në katin e tretë të saj, tek oda e burrave dhe divanhanja, në ballin e oxhaqeve të vatrës, formësuar bukur, po kështu, janë aplikuar motivet dekorative nga kulti i Diellit në formë ylli – rozete gjashtëmbëshe brendashkruar në rreth, realizuar në dy variacione kompozicionale.

³¹ Pikërisht sipër këtij guri, në fasadën tjetër – jugore të kullës, kemi të skalitur, po kështu në reliev të cekët, edhe një motiv tjetër astral të *gjysmëhënës*.

Përveç kësaj, po ashtu mësojmë se në të kaluarën, *gjarpri në rite e besime popullore* paraqitet si gjallesë ktonike me attribute totemike.

Totemizmi nënkupton besimin e bashkësive primitive - tradicionale njerëzore se, midis tyre, nga njëra anë, dhe kafshëve dhe bimëve, nga ana tjetër, ekziston një raport mitologjik në të cilin kafshët e më rrallë bimët, paraqiten në rolin e *mbrojtësit të të parit të fisit ose të gjinisë*. Kjo dukuri mitologjike që më herët ishte e njohur edhe për ilirët³², dhe në vazhdimësinë e saj të pakëputur, mbijetoi edhe në besimet popullore shqiptare.

Në kontekst të përkufizimit të sipërshtuar bën pjesë edhe kompleksi i ornamenteve me *simbolik kultesh të ndryshme*, skalitur në kullën e Ramadan SELIMIT në fshatin Krajk të Hasit.

Në portën harkore të kësaj kulle janë skalitur gjithsej 14 (katërmbëdhjetë) ornamente. Pastaj, në njërin prej gurëve këndor të kësaj kulle janë skalitur dy ornamente, ndërkaq në gurin tjetër është skalitur vetëm një ornament.

Me këtë rast, nuk do të ndalemi më gjerësisht në shpjegimin veç e veç dhe të plotë të simbolikës së këtyre ornamenteve, por vetëm do të theksojmë se ato i përkasin ornamenteve të *kultit ktonik* – kafshëve tokësore, pastaj, të *kultit të gjarprit*, të *kultit të diellit*, të *kultit të kalit*, si dhe të *kultit të vegjetacionit* së bashku me *kultin e shpezëve*.

Në kuadër të këtij kompleksi ornamentesh me simbolikë të caktuar, në teknikë të relievit të cekët, janë skalitur edhe ornamente të tjera të karakterit astral dhe apotropeik, siç janë gjysmëhëna dhe trekëndëshi, si dhe tri ornamente të tjera nga *kulti i mjeshtëriove*.

Përfundim

Së këndejmi, në këtë studim analitik provohet mirëfilli se kulti i gjarprit është pjesë përbërëse e trashëgimisë komplekse etnokulturore e

³² Aleksandër Stipçeviq, Ilirët... vep. cit. f.197.

popullit tonë. Ky kult u zhvillua, në vertikalen diakronike, në një vijimësi të pandërprerë në harkun kohorë që nga ilirët deri tek shqiptarët e kohës sonë.

Literatura

- Arheološko blago Kosova i Metohije, od neolita do ranog srednjeg veka, Katalog. Priština: Muzej 1998 (Beograd).
- Baçe A.; A. Meksi; E. Riza; GJ. Karaiskaj; P. Thomo. Historia e Arkitekturës shqiptare, Tiranë 1980.
- Bešlagić Šefik, Stari malisorsi nadgrobni spomenici u Vuksan Lekiću, Buletin i Muzeut të Kosovës, nr.X, Prishtinë 1970.
- Galović Radoslav, Predionica, neolitsko naselje kod Prištine, Muzej Kosova i Metohije, Priština 1959.
- Garašanin Milutin, Prahistorija, Beograd/Zagreb/Mostar 1982.
- Krasniqi Mark, Gjurmë e gjurmime, Prishtinë 1979.
- Mano-Zisi Djordje, Antika, Beograd/Zagreb/Mostar 1982.
- Opća enciklopedia, 7. Zagreb 1981.
- Sergejevski Dimitrije, Iz problematike ilirske umjetnosti, Godišnjak III/1, Sarajevo 1965.
- Stipçeviq Aleksandër, Ilirët, Historia, Jeta, Kultura, Prishtinë 1980.
- Stipçeviq Aleksandër, Simbolet e kultit të ilirët, Prishtinë 1983.
- Tirta Mark, Mitologjia ndër shqiptarët, Tiranë 2004.
- Xhemaj Ukë, Etnokultura shqiptare në Podgur, Prishtinë 2003.




Fig.1.



Fig.2.



Fig.3.



Fig.4.



Fig.5.



Fig.6.



Fig.7.



Fig.8.



Fig.9.



Fig.10.



Fig.11.




Fig.12.



Fig.13.



Fig.14.



Fig.15.



Fig.16.




Fig.17.



Fig.18.



Fig.19.




Fig.20.




Fig.21.



Fig.22.